



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 448/prot.

Elbasan, më 29. 4.2024

Lënda: Konfirmim akti


KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.39 datë 29.03.2024 “Për miratimin e procesit të privatizimit për truallin nën objekt të z.Nuredin Kurti, në zbatim të VKM-së nr.329 datë 22.05.2019”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI



Majlinda PERRIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK



Datë.03.04.2024

VENDIM

Nr. 1626/10 prot

Nr.39 dt.29.03.2024

“PËR MIRATIMIN E PROCESIT TË PRIVATIZIMIT PËR TRUALLIN NËN OBJEKT TË Z. NUREDIN KURTI, NË ZBATIM TË VKM-SË NR. 329, DATË 22.05.2019”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetë Qeverisjen Vendore”, ligjit nr.111/2018 “Për kadastrën”, VKM-së nr.329 datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, për rregjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësite e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt rregjistrimi”, Këshilli Bashkiak I mbledhur sot më date 29.03.2024 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1. Të përfundojë procesi i privatizimit për truallin nën objekt në favor të Z. Nuredin Riza Kurti.
2. Dosja e privatizimit të administrohet nga komisioni i ngritur për këtë qëllim pranë Bashkisë Librazhd, pasi të jetë plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm original të privatizimit (ose të njehsuar me origjinalin).
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Projekteve dhe Investimeve, Komisioni i Privatizimit dhe Sektori Juridik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT
Silvana HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHID

**RELACION
PËR PROJEKT-VENDIMIN**

**“Për formalizimin e kontratës së privatizimit me Z. Nuredin Kurti, në zbatim të VKM-së
Nr. 329, datë 22.05.2019”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetë Qeverisjen Vendore”, ligjit nr.111/2018 “Për kadastrën”, VKM-së nr.329 datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, për rregjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësite e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt rregjistrimi” I parashtrojmë Këshillit Bashkiak se:

Nisur nga kërkesa e Z. Nuredin Kurti, drejtuar ASHK Drejtorisë Vendore Librazhd për regjistrim truall, të blerë sipas mandat arkëtimit Nr 0094728, kjo e fundit me anë të shkresës Nr. 895/1 Prot, datë 26.04.2022, drejtuar Bashkisë Librazhd, kërkon plotësimin e dokumentacionit të dosjes nga ana e insatitucionit tonë me kontratën për shitjen e truallit.

Në dokumentet bashkëlidhur shkresës vendosur në dispozicion nga ASHK Drejtoria Vendore Librazhd, gjenden këto dokumente sipas kronologjisë si më poshtë:

1. Kopje kërkesë e Z. Nuredin Kurti;
2. Plan rilevimi;
3. Çertifikatë pronësie (dt. 22.11.2007) për objektin e ndërtuar me leje ndërtimi, me sip 20 m², me pronar Nuredin Kurti;
4. Vërtetim i dt. 12.08.1996, lëshuar nga Urbanistika(truall matur 36 m², me cmim shitje 480 lek/m²);
5. Vërtetim i dt. 12.06.1996, lëshuar nga Komisioni i Pronave i cili vërteton se sipërfaqja prej 36 m², nuk i është kthyer a kompensuar ndonjë pronari, ndaj mbetet pronë shtetërore;
6. Mandat pagese Nr 0094728, me vlerë 17283 lekë;
7. Vendim për dhënie Shesh Ndërtimi nga KRRT Librazhd Nr. 3, dt 24.01.1997;
8. Vendim për Leje ndërtimi nga KRRT Librazhd Nr. 2, dt 04.04.1997;
9. Harta treguese e pasurisë;
10. Plan Rilevimi për regjistrim pasurie sipas lejes së ndërtimit shoqëruar me relacion;
11. Planimetri e objektit;
12. Planvendosje e objektit;
13. Leje shfrytëzimi e objektit, Nr. 92 Prot, dt 02.02.2007.

Për sa më sipër, komisioni pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e paraqitur dhe administruar pranë Bashkisë Librazhd, arsyetoi se:

Në bazë të VKM-së Nr. 329, datë 22.5.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me ASHK, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi” pika 4 përcaktohet se:

“4. Bashkia, në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme, është organi që ngarkohet për plotësimin e mangësive të dokumentacionit ose, sipas rastit, për përfundimin e kalimit të pronësisë.”

Janë plotësuar kërkesat e pikës 6 të këtij vendimi pasi subjekti e disponon lirisht truallin e kërkuar, ka vendimin e këshillit të organit vendor të kohës për dhënien e sheshit për ndërtim dhe lejen e ndërtimit, dokumentin që vërteton pagesën e vlerës së truallit (mandat arkëtimin), lejen e shfrytëzimit që vërteton dhe ndërtimin e objektit mbi këtë truall.

Në këto kushte, mbështetur në VKM-në e sipërcituar pika 9.1. ku saktësohet se:

“Nëse bashkia konstaton se për pasurinë dokumentacioni nuk është i plotë, por ekziston të paktën vendimi i këshillit të organit vendor për dhënien e tokës për ndërtim, ajo procedon, sipas rastit:

a) duke i kërkuar subjektit përfitues të shlyejë pjesën e mbetur të çmimit të shitjes, të përcaktuar në aktin e kalimit të pronësisë; dhe/ose

b) duke thirrur subjektin përfitues për lidhjen e kontratës noteriale për kalimin e pronësisë mbi tokën, nëse ajo nuk është lidhur më parë, pasi të jetë shlyer vlera e plotë e çmimit të shitjes. Çmimi i shitjes do të jetë sipas vlerës së referencës në momentin e miratimit të vendimit të këshillit të organit vendor për dhënien e tokës për ndërtim. (Në rastin konkret vlera e truallit është shlyer plotësisht)

Për sa më sipër, vlerësuar dhe nga ASHK Drejtoria Vendore Librazhd, konstatohet se dokumentacioni i paraqitur rezulton i rregullt dhe në zbatim të dispozitave ligjore të VKM-së Nr. 329 datë 22.05.2019, dhe i vetmi element që mungon dhe pengon privatizimin është kontrata e shitblerjes së truallit.

Për këtë arsye, kërkojmë të formalizohet kontrata, duke dhënë miratimin Këshilli Bashkiak si organi kompetent dhe vendimarrës, dhe lidhja e kontratës sipas formës së kërkuar nga Kodi Civil në fuqi.

Konceptoi: Komisioni I privatizimit

Rajmon Pibkrashi
ENRI Gjura